



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 5 (827860)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 2 shkurt 2024

Ne jemi NATO, trupat shqiptare pjesë e stërvitjes “ShinyNight24”



Në kuadër të bashkëpunimit në fushën e arsimimit dhe trajnimit, gjeneral brigade Ylli Pulaj priti në një takim zyrtar pune, atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar për Shqipërinë dhe Malin e Zi, nënkolonel Timothy Wight-Boycott.

Gjeneral brigade Pulaj, pasi i uroi mirëseardhjen dhe e falënderoi për vizitën, vlerësoi bashkëpunimin midis dy vendeve, veçanërisht në fushën e arsimimit dhe trajnimit të ushtarakëve, duke nënvizuar vijimin në të ardhmen.

Nga ana e tij, nënkolonel Boycott e njohu komandantin e Kolegjit me planet arsimore, kurset dhe mundësitë e ofruara për zhvillimin e tyre nga pala britanike, duke shprehur se është i hapur për rritjen bashkëpunimit mes Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe Zyrës së Atasheut Ushtarak të Britanisë në Tiranë. Takimi u mbyll me shënim në librin e nderit dhe fotografi të përbashkët.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj priti atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Boycott



156 rekrutë, pjesë e Forcave të Armatosura

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë, në Repartin Ushtarak 1010, Shkodër dhe Repartin Ushtarak 1030, Berat, filloi Stërvitja Individuale Bazë, me 156 kandidatë për ushtar/detar.

Djem dhe vajza nga i gjithë vendi nisën rrugëtimin e tyre në këtë profesion fisnik për t'i shërbyer me vullnet, përkushtim dhe sakrificë atdheut.

Qëllimi i kursit SIB është transformimi nga qytetarë-civilë, në ushtarakë të disiplinuar, të motivuar e të përgatitur moralisht e fizikisht, me aftësitë bazë të luftëtarit për të zbatuar detyrat në operacion si individë.

Të ardhur nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, në Bunavi, rekrutët do të jetojnë dhe stërviten së bashku në të njëjtat ambiente e poligone, do të marrin e japin nga kultura e njëri-tjetrit, duke ngjizur e konkretizuar ditë pas dite shoqërinë ushtarake.



AFA, në Panairin e Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit

Në Panairin e Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit, në qytetin e Dibrës, një nismë dedikuar plotësisht të rinjve, informimit të tyre mbi programet e studimit që ofron AFA.

Akademia e Forcave të Armatosura është mundësia më e mirë për të patur një karrierë të sigurt. Me këtë nismë Forcat e Armatosura do të jenë në të gjitha qytetet e Shqipërisë.





Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti në takim atashetë ushtarakë të përfaqësive tona diplomatike

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, këtë fund janari priti në takim atashetë ushtarakë të përfaqësive tona diplomatike.

Takimi me atashetë ushtarakë, u realizua për të vlerësuar rolin e tyre domethënës në forcimin e marrëdhënieve me aleatët dhe partnerët strategjikë, si dhe arritjet e punës së tyre dhe prioritetet aktuale të Shqipërisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi theksoi se: “Vëmendja jonë kryesore është të sigurohemi që çdo efektiv i Forcave të Armatosura në zonat e tyre të përgjegjësisë të ketë maksimumin e resurseve dhe përkrahjes. Vlerësim për punën tuaj jo vetëm si përfaqësues dinjitozë të Forcave të Armatosura në nivel ushtarak, por edhe si ambasadorë në promovimin e vlerave dhe interesave tona kombëtare në arenën ndërkombëtare”.



Ne jemi NATO, trupat shqiptare pjesë e stërvitjes “ShinyNight24”

Trupat shqiptare në grup-batalionin e NATO-s në Bullgari treguan një nivel të lartë të përgatitjes gjatë stërvitjes “ShinyNight24” në poligonin Novo Selo. Mes 400 kolegëve të tyre nga Italia, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia dhe SHBA-ja, efektivet tanë treguan përkushtim dhe saktësi të lartë.

Stërvitja kishte si qëllim ndërveprimin mes trupave aleate, duke zhvilluar tema të rëndësishme si mbrojtja nga armët e dëmtimit në masë, kalimi i pengesave xhieri, qitje luftarake ditën dhe natën. Stërvitje të tilla janë shumë të rëndësishme për përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit mes trupave të NATO-s.



Në Forcën Tokësore u zhvillua takimi i dytë planëzues i Komandave të Forcave Tokësore të Ushtrive Evropiane "CEANCO-24"

Prej dy ditësh në mjediset e Forcës Tokësore u zhvillua takimi i dytë planëzues në kuadër të zhvillimit të Konferencës të XVII të Kryenënoficerëve të Forcave Tokësore të Ushtrive Evropiane "CEANCO 24".

Ky takim u zhvillua midis grupeve të punës së Forcës Tokësore si përfaqësues të FARSH dhe Komandës Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF).

Gjatë takimit u konfirmuan detyrimet e secilës palë dhe dakordësinë për modalitetet e zhvillimit sa më mirë të këtij takimi të rëndësishëm.

Në këtë takim, në krye të grupit përfaqësues të palës amerikane ishte krye nënoficeri i Komandës USAREUR-AF, kryekapiter Jeremiah Inman. Në përfundim të këtij takimi, grupi i palës amerikane u prit nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. Gjeneral brigade Xhebexhia, pasi u uroi mirëseardhjen miqve amerikanë u shpreh: "Ne e vlerësojmë shumë ndihmën dhe mbështetjen e palës amerikane në trajnimin e trupave tona, e në veçanti të trupës së nënoficerëve. Sa më e përgatitur të jetë kjo trupë aq më të përgatitur do të jenë efektivat tanë në fushën e luftimit. Për këtë dhe fokusi i punës sonë është në rritjen e përgatitjes profesionale të nënoficerëve tanë.

Besoj se dhe zhvillimi i kësaj konference do t' i shërbejë më së miri rritjes së bashkëpunimit midis ushtrive të vendeve anëtare të NATO-s".

Nga ana e tij kryekapiter Inman, pasi falënderoi komandantin e FT për pritjen dhe masat e marra për zhvillimin e konferencës CEANCO-24, u shpreh se konferenca do të jetë një shtysë përpara në bashkëpunimin midis ushtrive të vendeve të NATO-s.



Personeli mjekësor i Forcës Tokësore vijon stërvitjen para vlerësuese nga trajnuesit MEDEVAL

Personeli mjekësor i Qendrës Shëndetësore të Forcës Tokësore dhe batalionit të këmbësorisë së lehtë, vijojnë stërvitjen para vlerësuese mjekësore nën mbikëqyrjen e trajnuesve MEDEVAL, të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit. Përkushtimi dhe profesionalizmi i ekipit tonë mjekësor u prezantuan në mënyrën më të mirë gjatë kësaj stërvitjeje, duke zbatuar me saktësi procedurat e NATO-s.



Policia Ushtarake, zbulim, parandalim, mbrojtje, mision paqeruajtës



SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji uron rrugëtimin 32-vjeçar të Policisë Ushtarake



Të nderuar ushtarakë dhe punonjës civilë të Policisë Ushtarake! Kam nderin dhe kënaqësinë që t'ju përcjell urimet e mia të përzemërta këtë ditë të shënuar të 32-vjetorit të krijimit të Policisë Ushtarake.

Gjej rastin që të falënderoj në mënyrë të veçantë ish-drejtesit e kësaj strukture, si dhe të gjithë efektivat që kanë shërbyer me profesionalizëm dhe përkushtim të lartë ndër vite. Gjithashtu, dëshiroj që të adresoj një urim special edhe për personelin që shërben në misionet jashtë vendit.

Policia Ushtarake është një prej strukturave më të rëndësishme të Forcave të Armatosura, e cila ka mision sigurimin dhe ruajtjen e personelit dhe pronës ushtarake, mbajtjen e rregullit dhe disiplinës dhe zbulimin e veprave penale ushtarake.

Efektivët e Policisë Ushtarake kanë dhënë dhe vijnë që të japin kontribut të rëndësishëm në misionet dhe operacionet jashtë vendit në Afganistan, Kosovë, Egjipt dhe Detin Egje. Në të gjitha këto angazhime,

ju keni shërbyer me profesionalizëm dhe përkushtim, duke fituar respektin dhe besimin e partnerëve dhe të aleatëve.

Kontribut të spikatur efektivët e Policisë Ushtarake kanë dhënë edhe në përballimin e emergjencave civile, në mbështetjen dhe sigurimin e aktiviteteve të rëndësishme, si dhe në stërvitjet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Sot është një ditë e veçantë për të gjithë ne, e tekta përkujtojmë dhe bëjmë bilancin e arritjeve dhe të rezultateve, marrim në konsideratë edhe sfidat për të cilat duhet që të luftojmë e të përpigemi të gjithë së bashku, me qëllim që të jemi sa më të suksesshëm.

Shpreh bindjen e palëkundur se kjo strukturë speciale e Forcave të Armatosura, edhe në të ardhmen do të vijojë të zhvillohet dhe të përmirësojë kapacitetet në infrastrukturë, teknologji, sisteme dhe pajisje, duke u transformuar gradualisht në një polici moderne, sipas standardeve më të mira të NATO-s.

vitin 2008.

Në korrik të vitit 2007, në bazë të Urdhrit nr. 15, datë 17.01.2007 të MM, “Për ristrukturimin e Forcave të Armatosura”, batalioni i PU-së ishte pjesë organike e Komandës Mbështetëse, me varësi drejtimi administrativ në Komandën Mbështetëse dhe Komandim Operacional nga SHPFA. Në përbërje të këtij batalioni ishin 4 seksione të PU-së, në rrethet Shkodër, Durrës, Berat, Vlorë dhe 5 nën seksione të PU-së, në rrethet Kukës, Burrel, Elbasan, Korçë dhe Gjirokastrë, ku ushtrojnë veprimtaritë e tyre edhe sektorët e Policisë Kriminale, Policisë Gjyqësore, Qarkullimit Rrugor dhe Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimi.

Në vitin 2008, komandanti i batalionit të PU-së emërohet kolonel Xhevdet Zeneli. Në maj të vitit 2010, me Urdhër nr. 151/5, datë 24.12.2009 të MM, “Për kalimin në strukturën e re të FARSH”, struktura e Policisë Ushtarake kaloi në emërtimin “Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura”, në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9069, datë 15.05.2003, “Për Policinë Ushtarake në FA”, strukturë e cila vazhdon të funksionojë dhe në ditët e sotme. Në qershor të 2012, komandant i PU-së emërohet kolonel Syrja Gjoka. Në gusht të 2012, komandant i PU-së emërohet kolonel Ylli Zyla.



Në shtator të 2013, komandant i PU-së emërohet kolonel Xhevdet Zeneli.

Më tej në drejtimin e kësaj strukture vijuan edhe ushtarakë të tjerë, të cilët rritën performancën dhe përkushtimin e kësaj force elitare.

Veprimtaria e PU-së përcaktohet nga misioni dhe detyrat që parashikohen në ligjin, “Për Policinë Ushtarake në FARSH” dhe “Kodi Penal Ushtarak”. Hartimi dhe miratimi në Kuvend i këtij ligji në vitin 2003, shënon një ristrukturim të plotë të kësaj strukture.

Gjatë kësaj periudhe është punuar për kompletimin e PU-së me personel të motivuar, arsimuar në vendet anëtare të NATO-s, si në Turqi, Itali, Gjermani. Realizimi i misionit dhe detyrave funksionale është mbështetur në aktet ligjore e nënligjore.

Gjatë këtyre viteve PU-ja, është trajnuar nga specialistë të karabinierisë italiane, policisë ushtarake amerikane, gjermane dhe turke. Prej vitesh, njësia e PU-së po përgatit me një program të veçantë një nënrepart të nivelit togë NRF (NATO Response Force), si forcë e gatshme për të vepruar në përbërje të strukturës përkatëse të NATO-s, e aftë dhe e pajisur përshtatshmërisht për të përmbyshur detyrat.

Deri tani, PU-ja, me rreth 50 efektiva, ka kryer misione të ndryshe jashtë vendit në Irak dhe Afganistan, në mbështetje të FA-së dhe në shtabe të ndryshme ndërkombëtare. Gjithashtu, PU-ja ka kryer një mision në operacionin ushtarak “ISAF”, në Kabul, Afganistan. Kontingjenti i kësaj toge përbëhej nga një efektivi prej 22 vetash.

Një kontribut të madh, efektivi i PU-së ka dhënë në emergjencat civile, ku kanë treguar gatishmëri dhe profesionalizëm në kryerjen e detyrave të marra.

Tashmë, struktura e PU-së është e përgatitur

detyrave dhe objektivave që dalin nga ky mision. Gjatë këtyre viteve të fundit PU-ja, është trajnuar nga specialist të huaj si ata të karabinierisë italiane, policisë ushtarake amerikane, gjermane dhe turke. Gjithashtu ajo po përgatitet edhe si forcë e gatshme për të vepruar në përbërje të strukturës përkatëse të NATO-s, e aftë dhe e pajisur përshtatshmërisht për të përmbyshur detyrat. Një kontribut të madh, efektivi i PU-së jep në emergjencat civile.

Misioni i Policisë Ushtarake

Ruajtja e rendit ushtarak në FARSH, zbulimi, parandalimi, ndjekja e veprimtarisë kriminale, angazhimi në luftën kundër terrorizmit, marrja pjesë në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, si dhe mbrojtja e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura nga veprimet e kundërligjshme.

Struktura e PU-së është e përgatitur për të vepruar në të gjithë spektrin e misionit, detyrave, si edhe të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe humanitare

Detyrat

• Siguron rendin ushtarak jashtë reparteve ushtarake në mjediset publike e jopublike.

• Mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e ushtarakut nga çdo veprim i paligjshëm kur ato cenohen për shkak të detyrës.

• Mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të FA-së nga veprimtari të kundërligjshme.

• Ndërhyn për të mënjanuar aktet e terrorizmit në FA.

• Punon për zbulimin, parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale ndaj pjesëtarëve të FA-së, pronës dhe objekteve ushtarake.

• Zbaton vendimet e gjykatës, aktet e Prokurorisë Ushtarake për kërkimin, kapjen dhe sjelljen forcërisht të ushtarakëve që i fshihen procedimit penal ose i shmangen vuajtjes së dënimit.

• Kontrollon dhe siguron transportin ushtarak.

• Kontrollon lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe teknikës ushtarake.

• Kontrollon e merr masa për zbatimin e legjislacionit të Masat e Ndërhyrjes kundra Zjarrit (MNZ).

• Siguron zbatimin e rendit ushtarak gjatë zhvillimit të stërvitjeve, veprimtarisë dhe ceremonive ushtarake të organizuara nga SHPFA.

• Shoqëron e siguron personalitetet e larta ushtarake të FA-së, si dhe delegacionet e huaja të njehsuara me to.

• Kryen detyra në interes të forcave ushtarake shqiptare që kryejnë misione jashtë shtetit, si dhe të forcave të huaja ushtarake që veprojnë në Shqipëri në përputhje me legjislacionin në fuqi.

• Kryen e mbështet operacionet humanitare.



Prof. As. Dr. Gëzim MUSTAJ

Bektash Shametai u lind, më 13 dhjetor 1942, në fshatin Dorëz të krahinës Sinanaj të rrethit të Tepelenës. Familja dhe fshati ku u lindi dhe u rrit, e edukoi me atdhedashuri dhe patriotizëm. Familje me rrënjë të thella patriotike dhe me kontribute për çështjen e lirisë e pavarësisë së Atdheut.

Pasi përfundoi arsimin fillor në Dorëz dhe atë 7- vjeçar në Shkollën “Selam Musaj” në Sinanaj, nga viti 1957 -1961 do të vazhdonte arsimin e mesëm në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë dhe më pas në vitin 1963 përfundon Shkollën e Bashkuar të Oficerëve me rezultate shumë të mira.

I palodhur dhe kurdoherë në krye të detyrës, Bektash Shametai

Karrierën ushtarake Bektashi e filloi si Komandant toge dhe zëvendëskomandant kompanie këmbësorie në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve Tiranë, pra aty ku përfundoi edhe studimet e larta, për të qëndruar shumë pak, vetëm një vit. Falë aftësive dhe punës së tij të palodhur në vitin 1964, shumë i ri do të vazhdonte karrierën ushtarake si Instruktor i parë në Degën e Shtabeve në Drejtorinë Operative, në MM, deri në vitin 1969. Gjatë kësaj periudhe, nga viti 1965 deri në vitin 1970, mbaron studimet me korrespondencë në Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë-Letërsi.

Më tej, detyrat që do t'i besoheshin, dhe të cilat do i kryente me përkushtim dhe devotshmëri, ishin: Komandant kompanie të motorizuar në Brigadën e Tankeve Sauk; Shef Shtabi i batalionit të motorizuar në Brigadën e Tankeve Sauk; Komandant batalioni këmbësorisë së motorizuar në Brigadën e Tankeve Sauk; Shef Shtabi i Brigadës së rinisë shkollore, Tiranë; Student në Akademinë Ushtarake; Komisar i Brigadës 8 Sulmuese, Kukës; Shef Shtabi i Divizionit 49 të Këmbësorisë Kukës; Komandant i Divizionit 49 të Këmbësorisë, Kukës; Shef i Shërbimit të Garnizonit, Tiranë, Shef i Organizimit të Divizionit i Këmbësorisë, Tiranë.

Në mars të vitit 2000, pasi fitoi Lotarinë Amerikane së bashku me familjen u vendos në New York, SHBA.

Divizioni i Kukësit kishte një nga drejtimet më kryesore të mbrojtjes sonë strategjike, andej mendohej rreziku më i madh. I gjithë drejtimi i mbrojtjes kishte përballë Jugosllavinë dhe një relief malor. Këtë detyrë komandant Bektashi e kreu me nder dhe devotshmëri.

Ata që e takonin për herë të parë, mendonin se komandant Bektashi është hijerëndë, në fakt ky ishte një perceptim shumë i gabuar, sepse kushdo që e njeh dhe ka punuar me Bektashin menjëherë do e heqë nga mendja këtë ide. Ne oficerët e rinj e shikonim me shumë dashamirësi dhe e kishim zili në kuptimin e mirë të fjalës për sjelljen e tij dhe sidomos “kaligrafinë” që kishte. Vinte në stërvitjet e shtabit të brigadave dhe kur na shikonte hartat menjëherë do merrte pendën dhe të rregullonte kokat e hartave, duke na thënë: “Jeni oficer të rinj dhe e keni perspektivën përpara. Një hartë e punuar mirë duket që tek koka”.

Isha me punë në batalionin mitraljer, Cahan. Kishte ardhur për një takim me oficerët dhe ushtarët Komandant Bektashi, që ishte Komandanti i Divizionit. Pas takimit, ne oficerët e rinj menduam se kishte ikur dhe unë me një shokun tim dolëm nga reparti dhe do zbrisnim në Krumë për

Redaksia e shtypit ushtarak, falënderon bashkëpunëtorët tanë, ish-ushtarakë me kontribute të çmuara në profesionin e tyre në ‘Mbrotjtje të Atdheut, pa kursyer as jetën’, për përkushtimin dhe dëshirën e madhe për të sjellë pranë redaksisë jetën dhe aktivitetin e miqve, kolegëve, bashkëpunëtorëve të tyre në rrugëtimin e vështirë dhe sfidues të ushtarakut.

Edhe pse përtej oqeanit, zemra e tyre është në Shqipëri. Tek çdo fjalë lexuesit e shtypit do shohin mallin dhe dashurinë që kanë marrë me vete, në ato vise të largëta. Mirënjohje të nderuar zonja dhe zotërinj, ish-ushtarakë që ende vazhdoni dhe kontribuoni për atdheun tonë.

Bektash Shametai, portreti i një ushtaraku model



të ikur me leje. Pranë këmbëve na ndaloi makina e komandantit. Si të rinj që ishim u frikësua, por ai na pyeti duke qeshur, se ku po shkonim? Ne si me ndrojtje i thamë, që po shkonim në Kukës, pasi do iknim me leje. Ai na tha të hipnim në makinë dhe gjithë rrugën bisedoi me ne për shumë probleme. Edhe sot pas kaq vitesh e kujtoj se e gjithë rruga për rreth tre orë na u duk shumë e shkurtër.

Ky ishte Komandant Bektashi, që pavarësisht nga detyra e lartë që kishte, në rrugëtimin e karrierës së tij ushtarake si oficer, dukshëm u shfaqën cilësitë e larta morale që e karakterizuan: thjeshtësia, kurdoherë korrekt, dashamirësia e respekti për cilindo, i sjellshëm, i ndershëm, i çiltër, i hapur, i vëmendshëm ndaj kujtdo e i gjendur për këdo, i sinqertë me të gjithë.

Bektashi është një burrë fisnik, një shok e mik i mirë. Zelli dhe dëshira për të mësuar nuk i ka munguar asnjëherë. Të gjitha shkollat ai i mbaroi me rezultate të shkëlqyera. E karakterizon etja për dije, këtë e tregon edhe fakti pasi në vitin 2000-2001, në moshën 58-vjeçare mbaroi studimet në Kolejin “Lehman Colege” në Bronx, New York, USA.

Gjatë punës ai është vlerësuar me shumë urdhra dhe një medalje nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Ministria e Mbrojtjes.

Komandant Bektashi është jo vetëm specialist e drejtues ushtarak i shkëlqyer, një mik e shok i dashur, korrekt dhe i sinqertë, por dhe një bashkëshort, prind e gjysh shembullor. Ai së bashku me bashkëshorten Këzen rritën dhe edukuan tre fëmijë shembullorë, si vetë prindërit e tyre. Të tre kanë kryer studimet e larta në Amerikë dhe janë intelektualë shumë të suksesshëm në profesionet e tyre. Djali i madh, Eltoni, një oficer karriere në Forcat e Armatosura Shqiptare shumë i mirë, por edhe këtu një oficer i sigurisë së lartë i shkëlqyer.

Pse dreqin e hëngra atë mollë?!

Pse dreqin e hëngra atë mollë?! A është mëkat të bësh atë që do?! Jo...por i tillë është kur bëhet nga një grua... Ndryshe unë do isha ti..., burri i fortë që vetë më shtyve drejt ‘ngasjes’.

Pse dreqin e hëngra atë mollë?!, pyetje që zanafillën e saj e ka nga kohët e lashta. Në epokën mesjetare, femrës nuk i duhej shumë për t’u etiketuar si mëkatore: vetë qenia femër ishte tashmë një faj. Të akuzuara si shkaktare e gabimit të Evës, që e çoi Adamin në mëkatin origjinal, gratë e mesjetës e shkuan jetën në inferioritet jo vetëm shoqëror, por edhe intelektual. E konsideruar e brishtë nga natyra dhe e prirur për të rënë pre e tundimeve të djallit, shumë prej mëkateve për të cilat u akuzuan buronin nga fantazia dhe frika misogjene e burrit mesjetar.

Që njerëzimi e ka humbur parajsën tokësore për shkak të kafshimit të një molle, kjo është një gjë që as ka ndryshuar e as nuk do të ndryshojë ndonjëherë. Edhe pse në të vërtetë, me Bibël në dorë po ta shohim, fruti që bëri që të bien në tundim Adami dhe Eva nuk binte aspak nga një mollë, por nga një pemë pa emër. Në fakt, ndalimi i famshëm i Zotit tingëllonte pak a shumë kështu: “Ti mund të hash frute nga të gjithë pemët e kopshtit, por nga pema e dijes së të mirës dhe të keqes nuk duhet të hash, sepse, kur t’i të hash prej saj, me siguri që do të vdesësh”

Gruaja drejtonte jetën e saj dhe të të tjerëve, duke patur besim në intuitën e vet, në mençurinë e lindur; duke përshkuar rrugën e brendshme të diktuar nga vetë nëna e saj apo nga të gjithë nënat e tjera që kishin jetuar para saj. Njihte ritmet e tokës, mësimin e kafshëve, fuqitë shëruese të bimëve, ciklet e jetës, pranonte hapat e iniciacionit femëror me sinjeritet dhe përkushtim.

Por çfarë ndodh sot, kur gruaja i bën vetes një pyetje të tillë?

Duket sikur përballë kësaj pyetje gruaja fillon të ndiejë tingëllimin e një jehone të largët, ku vërviten shumë zëra, por në momentin kur do të formulojë përgjigjen nuk gjen më fjalë, dhe ajo ndjenja e përkatësisë ndaj Universit rresht.

E pra, përgjigja ekziston, atje në shtresat e thella të psikikës, e mbuluar nga shekuj të tërë plot me rregulla, pengesa, konvencione, paragjykime, “edukate të mirë”. Nuk ka qenë veç bota mashkullore që e ka dëbuar botën femërore kaq larg, por dhe vetë gratë, tashmë aq të çrrënjosura nga vetja e tyre sa të mos njohin dot më forcat që i jepnin gjallëri, ndërkohë që përshtateshin me një model social sipërfaqësor dhe shtypës.

Lëvizjet feministe të kohëve të fundit kanë hapur disa rrugë, kanë shqyer me guxim dhe mlllef kangjellat që pengonin lirinë sociale dhe barazinë e të drejtave, por kjo luftë e vullshme nuk ka qenë në gjendje të rimëkëmbë farën e lashtë, dritën e lashtë, bukurinë e lashtë që çdo grua bart në vet-vete (dhe kjo jo prej dobësisë, por sepse në asnjë luftë s’mund të ketë ekuilibër).

Natyrë femërore nuk është ajo e bindjes në heshtje, as ajo e të jetuarit një barazi që e mbyl shpirtin, por ajo e të jetuarit misterin që ndodhet në secilën grua; është ajo e mbështjelljes me Dritën e shpirtit, e kënaqësisë që rrjedh nga vetë kënga e saj.

Nuk është më e mjaftueshme fjala, kemi folur mjaft, nuk është më i mjaftueshëm veprimi, kemi vepruar mjaft. Duhet të JEMI, të jemi Gra, të jemi Dhuratë. Fjala “grua” fton simbolin e “dhuratës”. Por të “dhurosh” nuk do të thotë të japësh diçka me detyrim, siç na kanë edukuar, nuk do të thotë të kërkosh atë perfeksionin që plotëson idenë që kemi krijuar për veten, ose që të tjerë kanë krijuar për ne, duke na thënë “kështu është mirë”, “kështu duhet”. Të jesh dhuratë nuk do të thotë thjeshtë të japësh. Do të thotë të shndërrosh natyrën tënde femërore në një dhuratë, në atë pikë sa të bëhesh dritë për të tjerët në mënyrë plotësisht të natyr-



shme, pa u krenuar, pa u dukur, pa sforcim. Dritë që thjesht vjen së brendshmi, s’ke ç’ ti bësh, ajo thjesht është aty për t’u shfaqur...

Femërorja nuk është feminizmi

Gruaja që është vërtetë grua e do burrin, ajo dashuron, ndjen kënaqësi, fal jetën, vuan, shëron, mbron, buzëqesh, krijon, dhuron. Nuk ndan kurrë, nuk largon, nuk i thotë kurrë burrit: unë jam më e mirë se ti, unë jam më shumë se ti, ose unë jam mirë edhe pa ty. Gruaja bashkon, beson, këmbëngul, pret. Gruaja ka durim dhe di të presë, sepse e madhe është dashuria e saj...

Kur gratë takohen më njëra-tjetrën me qëllimin e përbashkët që të ndajnë bashkë një rrugë dijeje, me qëllimin të përvetësojnë sërish atë rrymën e shenjtë dhe instiktuale që përshkon qenien, ndodh diçka e çuditshme: perceptimi i zjarrit të brendshëm... Kur gruaja shpreh vetveten, lirisht, bashkë me gra të tjera, ngrihet një forcë jashtëzakonisht e ngrohtë, gjithëpërfshirëse, e ndritshme; një energji në gjendje të shkundë rregullat, ligjet, institucionet, sistemet, të shkojë përtej çdo limiti, të shkulë portat prek çeliku të ngritura në shekuj të tërë represioni, të sjellë në jetë zanën dhe sh-trigën njëkohësisht. Dhe kjo mund të ndodhë pa britma, pa inate, mund të ndodhë me delikatesë dhe dashuri, me liri dhe respekt, sepse vetëm nëse gruaja i jepet vetvetes mund të ndiejë sa e madhe është fuqia që ka brenda...

Gruaja ka duar që prekin lehtë dhe fuqishëm, duar që janë në gjendje të thurin rrjeta të pafundme dashurie dhe durimi, mëshirimi dhe faljeje. Gruaja ka këmbë të mbështetura mirë mbi tokë për të marrë energjinë e Nënës Tokë dhe për t’ia shpërndarë të tjerëve, këmbë që dinë të ecin, të ecin e të ecin për të gjetur të Vërtetat më të fshehta dhe që dinë më pas të kërcejnë për të shkëmbyer këto të vërteta me qiellin. Gruaja ka barkun që gjeneron, e mban, e ushqen dhe e lind jetën, ka

barkun e ngrohtë dhe magjik, i cili është zgjedhur posaçërisht për të mbartur farën e jetës. Gruaja ka gjinjtë e butë që japin ushqim, ngrohtësi, prehje, përkëdhelje dhe gëzim, aty ku foshnja mund të gjejë përqafimin hyjnor që sapo ka humbur. Gruaja ka trupin që mund të këndojë jetën dhe kalimet e saj të vazhdueshme midis gëzimit dhe dhembjes, vdekjes dhe rilindjes, një trup që prej ngaherë e di që në këtë shkrirje të dy të kundërtave qëndron fuqia e Dritës së fshehur, ajo që bën për vete të dashurin, ushqen fëmijën, lind jetën fizike, psikike dhe shpirtërore çdo herë që është e nevojshme.

Gruaja di, mjafton të dojë të dijë, ajo di

Gratë e forta kanë një impakt kaq të madh në jetët tona, saqë nuk mund të mos prekemi prej tyre. Ti mund të jesh rritur nga një grua e fortë, apo ke patur një grua të fortë si model në jetën tënde, që ka ndihmuar në formësimin tënd sot. Nëse identifikohesh si një grua e fortë, atëherë me siguri do të gjesh tek vetja tiparet e mëposhtme.

1. Ke kurajë të pashoqe

Nëse je një grua e fortë, atëherë ti je në këmbë për të përballuar çdo sfidë, pa marrë parasysh se çfarë përfshin ajo. Një grua e fortë del nga çdo situatë që nuk i shërben interesit më të mirë të saj, gjë e cila gjithashtu kërkon guxim të madh. Mund të ndjesh frikë, por ti shtyn fort përtej frikës, dhe qëndron në këmbë përballë vështirësisë ose rrezikut, gjë e cila ju bën tepër të fuqishme dhe një forcë për t’u marrë mirë parasysh.

2. E do veten, pavarësisht gjithçkaje

Nëse e do veten, pavarësisht nga gabimet që ke dhe të metat e tua të perceptuara, atëherë je me siguri një grua e fortë. Dashuria për veten kërkon përpjekje të madhe dhe kohë për t’u kultivuar, dhe vetëm gratë e forta e dinë se si ta duan vërtetë veten e tyre.

3. Nuk varesh nga askush tjetër

Gratë e pavarura nuk mbështeten tek askush tjetër, për mirëqenien e tyre financiare, emocionale, mendore apo fizike. Mund të duket e frikshme të dalësh në botë e vetme, por gratë e forta nuk e lënë frikën nga dështimi që t’i frenojë. Kini besim në veten tuaj për të përballuar çdo sfidë, gjë që e bën një grua e fortë.

4. Je e mirë dhe e dhembshur

“Fjalët e mira janë të shkurtra dhe të lehta për t’u thënë, por jehona e tyre është vërtetë e pafundme”, – Nënë Tereza. Gratë e forta nuk e konsiderojnë mirësinë një dobësi; ato e shohin atë si një pjesë shumë të domosdoshme të qenies së tyre, e cila i ndihmon për t’u lidhur me të tjerët emocionalisht, dhe për të ngritur të tjerët, në vend se t’i “shembin”. Gratë e forta nuk e përdorin veten e tyre për keq, por për mirë.

5. Ti gjithmonë ndjek intuitën

Gratë e forta nuk dëgjojnë asnjë zë në jetën e tyre, por vetëm zërin e tyre të brendshëm. Ato ndjekin vetëm instiktin, sepse askush nuk e di më mirë se ato, se çfarë duan me të vërtetë dhe për çfarë kanë nevojë në jetë. Intuita jote flet me zë të lartë, dhe ti ke mësuar se si ta qetësosh mendjen tënde dhe vërtetë ta dëgjosh atë.

6. Të tjerët të konsiderojnë një shembull shumë të mirë për t’u ndjekur

Gratë dhe burrat e tjerë të shohin me admirim për personalitetin e mrekullueshëm, qëndrimin dhe trajtimin e të tjerëve. Njerëzit vijnë tek ti për këshilla, ose edhe vetëm për të të takuar biseduar për pak. Ata me të vërtetë duan shoqërinë tënde, pasi rrezaton lumturi, urtësi, mirësi dhe forcë.

7. Di si ta bësh vetë, lumturinë tënde

Gratë e forta gjithashtu nuk varen nga të tjerët për lumturinë e tyre; ato e krijojnë atë. Nëse je një grua e fortë, ti kurrë nuk lë ndjenjat e njerëzve të tjerë që t’ju vënë përfund. Gjithashtu nuk le trazirat e tua të brendshme, që të udhëheqin jetën tënde – ti ngrihesh mbi to dhe nxjerr më të mirën nga ky udhëtim i bukur.

8. Nuk ke frikë për të treguar emocionet e tua

“Asnjëherë mos të të vijë turp se si mendon. Ti ke të drejtë të ndiesh çdo emocion që dëshiron”, – Demi Lovato.

Gratë e forta gjithashtu nuk qortojnë veten ose të tjerët për ndjenjat dhe emocionet që ndajnë. Ato e dinë se frenimi i emocioneve vetëm sa krijon më shumë probleme në afat të gjatë, dhe fshehja e ndjenjave të tua nuk është aspak e shëndetshme, shkruan. Ato thonë atë që mendojnë, shprehin ndjenjat e thella dhe mendimet, dhe më tej ecin përpara me jetën e tyre.

9. Ti gjithmonë beson tek vetvetja

Besimi tek vetja të lejon të arrish lartësi të reja në jetë, por vetëm një grua e fortë e di këtë. Ato e dinë se të kesh besim në aftësitë e tua, është thelbësore për të krijuar jetën që do të jetosh.

10. I tregon të tjerëve dashuri dhe mbështetje të pakufizuar

Një studim i dashurisë së nënës në tru, krahasuar me dashurinë romantike, zbuloi se zonat e trurit që janë aktive në dashurinë romantike, janë gjithashtu aktive në dashurinë e nënës. Kjo tregon se, bazuar në dashurinë që nëna jote tregoi për ty kur ishte fëmijë, ti ke themelin për t’u dhënë të tjerëve të njëjtën dashuri të pakushtëzuar.



N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

Lufta në Ukrainë, ndikimet në sistemin e sigurisë dhe mbrojtjes në rajon dhe vendin tonë

Lufta aktuale në Ukrainë përfaqëson një konflikt konvencional me intensitet të lartë, i pashembullt në historinë bashkëkohore evropiane. Duke përdorur një metodë cilësore, shumë studiues paraqesin karakterin e luftës dhe identifikojnë specifikat kryesore të saj nëpërmjet optikës me veprimtari të shumë fushave, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë bëhen obligime vlerësimi edhe për rajonin tonë. Identifikimi i mësimave në fazat e luftës në Ukrainë është një përpjekje serioze, por e nevojshme, sepse dinamika aktuale kërkon përshtatje të shpejtë të strategjisë, përforcimi të sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes, rritjen e aftësive dhe kapaciteteve të forcave të armatosura drejt përshtatjes në koherencë me mjedisin. Kjo përpjekje është pa dyshim rrjedhojë e punës vëzhguese që nga aneksimi i Krimesë në 2014, por më serioze dhe që ka shumë rëndësi, që pas Pushtimit rus të Ukrainës, në shkurt 2022.

Vëzhgimet dhe rekomandimet e përshkruara do të jenë gjithëpërfshirëse dhe të identifikuar nëpër linja politike dhe ushtarake. Megjithatë, ato janë paraprake dhe nuk duhen kuptuar si shteruese. Por, ato do të ndikojnë për përmirësimin e sistemit të planifikimit dhe vendosjen e koncepteve të reja në konceptet doktrinare të FA-së.

Pika e nisjes për identifikimin e rekomandimeve të politikave të ardhshme është ajo që pas më shumë se tre dekadash, mjedisi i sigurisë duhet të investojë një sasi të konsiderueshme burimesh për të vlerësuar këtë konflikt të zgjatur me armikun e avancuar teknologjikisht. Pra, mbrojtja në tërësinë e vet, në kontekstin strategjik, kërkon një investim kuptimplotë për shkak të mendësisë shoqërore për t'u mësuar dhe për të reaguar ndaj ndryshimeve të ndodhura në mjedisin e sigurisë globale, por edhe rajonale, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë.

Disa konsiderata politike

Kompleksiteti dhe intensiteti i luftës në Ukrainë ka treguar shtrirjen e sfidave për menaxhimin strategjik të mbrojtjes. Drejtimi ka kërkuar të sigurojë udhëheqje të fortë politike dhe ushtarake, vendosmëri, elasticitet, gatishmëri dhe efektivitet koordinimi që pasqyron nivelin më të lartë të kompleksitetit të mbrojtjes, duke përfshirë elementë ushtarakë dhe jo ushtarakë të fuqisë kombëtare.

Është i një rëndësie të madhe për zgjerimin e konceptit të mbrojtjes, të bazuar në elementin e saj tradicional ushtarak, qasja e qeverisë dhe e gjithë shoqërisë ndaj mbrojtjes. Ndërtimi i sistemit të mbrojtjes me forca të armatosura relativisht të vogla profesionale do të jetë një mundësi ose një opsion në peizazhin strategjik bashkëkohor. Pra, janë momentet që shoqëria duhet të kontribuojë në mbrojtjen e vendit dhe duhet të përgatitet në mënyrë adekuate për të pasur rol kërkuar. Ky është realiteti në kontekstin ukrainas, ku mbështetja dhe pjesëmarrja aktive e popullsisë në përpjekjet e luftës mbeten elementë kyç që ndihmojnë në zbutjen e ofensivës ruse.

Një linjë e rëndësishme përpjekjesh qëndron në domosdoshmërinë për të përshpejtuar procesin kritik të përshtatjes së kornizës ligjore për të lejuar vendimmarrje në kohë dhe reagim efektiv në rast të një konflikti. Bashkëpunimi racional me shoqërinë dhe institucionet kërkimore, duke përfshirë akademikët është i një rëndësie të madhe për të siguruar furnizimin, mbështetjen gjatë ciklit jetësor dhe inovacion më të shpejtë në fushën e mbrojtjes. Dhe më domethënësjë, kriteret për vendimmarrje, që bëhen efektive, kur bëhet fjalë për përshtatjen e kuadrit ligjor, janë siguria, gatishmëria, elasticiteti, autonomia e vendimmarrja. Kriteret si efikasiteti dhe përballueshmëria duhet të luajnë rol dytësor për mbrojtjen e ardhshme, formulimin e politikave dhe zbatimin e tyre. Lufta në Ukrainë mund të etiketohet si një konflikt lokal por me implikime globale.

Strategjitë gjithëpërfshirëse që përfshijnë orkestrimin e të gjithë elementëve të fuqisë kombëtare dhe interesave strategjike të përcaktuara qartë dhe prioritetet e shtetit, mund të jenë përgjigja e duhur ndaj kësaj sfide.

Konflikti solli gjithashtu në vëmendje të theksuar mbrojtjen e rajonit, të vendit tonë por dhe aleatëve të saj. Mbrojtja është bërë prioritet në axhendën politike. Lufta në Evropë ka ndikuar në diskursin e debatit publik. Ajo dëshmon se shumica e popullsisë e mbështet veprimtarinë si anëtare e NATO-s. Për më tepër, shumica e shoqërisë mbështet rritjen e shpenzimeve për mbrojtjen dhe investimet në modernizimin e FA-së. Derisa tendenca është duke u përmirësuar, gatishmëria për të kontribuar aktivisht në mbrojtjen e vendit është rritur. Përgjigja efektive e politikës së mbrojtjes mund kërkojë rritjen e aftësive dhe drejtimin e duhur të instrumentit strategjik të komunikimit për të zbutur problematikën.

Lufta ka nënvizuar gjithashtu domosdoshmërinë për reagim të fortë dhe koheziv kolektiv. Pushtimi i drejtpërdrejtë ushtarak i Rusisë në Ukrainë shkaktoi tronditje strategjike për shumë liderë politikë në Evropë dhe vuri në rrezik sigurinë dhe prosperitetin euroatlantik.



Erozioni i mëtejshëm i aftësive mbrojtëse dhe kapaciteteve të shtyllës evropiane brenda NATO-s do të përbënte nivel rreziqesh.

Në këtë drejtim, ne duhet të bashkoheni me reagimin e drejtë të Aleancës në mbrojtjen kolektive dhe të përmbushim angazhimet e saj ndërkombëtare ndaj aleatëve dhe partnerëve të saj.

Disa konsiderata ushtarake

Përshkallëzimi i luftës në krahun lindor të NATO-s do të kërkonte përdorimin e forcave përtej aftësive të Forcave të Armatosura profesionale në strukturën e vendosjes në kohë paqeje.

Kjo do të thotë se duhet të përmirësojmë përgatitjen për burimet njerëzore dhe materiale përpara se të lindë një krizë e tillë. Karakteri e Luftës Ruso-Ukrainase demonstroi një kërkesë të madhe për municione dhe kapacitete industriale. Megjithatë, furnizimet me material ushtarak janë shumë të kufizuara dhe kërkesat e konfliktit me intensitet të lartë duhet të tejkalojnë kapacitetin e industrisë së sotme.

Gjithashtu, është e nevojshme të rindërtohen aftësitë e krijuara në mbrojtjen e vendit tonë dhe vendeve të tjera euroatlantike. Këto përfshijnë forcimin e mbrojtjes, qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike dhe sigurimin e kapaciteteve të sistemit të integruar logjistik. Thelbësore është gjithashtu gatishmëria dhe disponueshmëria e rezervave, të cilat zhvillohen në mënyrë graduale.

Sot, ne duhet të demonstrojmë kapacitete të tilla që të jenë në gjendje të ofrojnë mbështetje të vendit pritës dhe lehtësira të sigurta për trupat aleate.

Lufta në Ukrainë konfirmoi rëndësinë në rritje njohjes së fushës së hapësirës kibernetike, si dhe konkurrencën në spektrin elektromagnetik. Qasja e informacionit dhe përpunimi i të dhënave nga të gjitha fushat janë çelësi për përmirësimin e zinxhirit të komandës dhe kontrollit në operacione dhe për këtë arsye duhet të jetë prioritet për zhvillimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura. Bazuar në rezultatet e vëzhgimit dhe analizës, gjetja kryesore është prania e aspekteve të ndryshme të të gjitha gjeneratave të njohura të luftës dhe karakteristikave të tyre në këtë konflikt të veçantë. Përveç kësaj, hulumtimi konfirmon me njëfarë niveli sigurie se ka disa elementë të rinj, duke demonstruar kështu një karakter në zhvillim të luftës. Studiuesit, akademikët, ushtarakët mund të konkludojnë se Lufta në Ukrainë është në një shkallë të gjerë, ku bashkëveprojnë shumë fusha dhe konflikte konvencionale me elementë simetrikë dhe asimetrikë dhe me diversitet të gjerë mjediesh e taktikash në zhvillim nga të dyja palët. Kjo luftë përmban përvojën disavjeçare të gërshetuar dhe me mjetet moderne, satelitët hapësinorë dhe asetet kibernetikë. Këto mjete të sofistikuar dhe sistemet e shtrenjta të armëve të shekullit të 21-të janë përdorur së bashku me ato komerciale ose asete me përdorim të dyfishtë. Koha reale dhe informacioni i saktë janë bërë absolutisht përcaktues vendimtarë për fitimin e avantazhit ndaj kundërshtarit. Ndërsa në të njëjtën kohë, pushtimi rus është padyshim një luftë gërryese dhe për këtë arsye kërkon qëndrueshmëri të lartë në moralin shoqëror, kapacitetet e qëndrueshme prodhuese dhe shpenzimet në burimet kombëtare.

Më në fund, janë identifikuar mësimet e ndryshme, kryesisht nevoja për të pranuar angazhimin vendimtar politik dhe ushtarak, duke marrë parasysh mundësinë që rajoni apo vendi ynë mund të

përfshihet në një konflikt. Prandaj, kërkon investim në shumë fusha nga aspektet legjislativë sipas karakterit të luftës në Ukrainë për të ndërtuar fushat kryesore të aftësive ushtarake me synimin për të mbizotëruar luftën intensive moderne.

Fshati Qestorat, në krahinën e Lunxhërisë në Gjirokastrë, është e pabesueshme, por ka qenë realitet, sepse aty ka patur një shkollë të mesme bujqësore, si dhe një konvikt për nxënës. Ka qenë si të thuash një fshat-qytet i zhvilluar. Këtu vijon historia e Mësuesit të Popullit Koto Hoxhi, i cili u burgos dhe u helmua nga grekët, sepse në këtë shkollë u fol dhe u mësua gjuha shqipe, në vitin 1900. Qestorati është vendlindja e patriotëve dhe luftëtarëve të lirisë e pavarësisë Koto Hoxhit dhe Kristaq Zografit.

Nga Qestorati gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dolën mjaft partizanë dhe luftëtarë të lirisë, midis të cilëve u shquan Misto Naqo Çipi, zëvendëskomandant i batalionit “Misto Mame”, Sofo Lame Papavasili, Ndriko Pandeli Kushta, Panajot Pilo Leku, Stavro Petro Floku, Telo Sevo Mitrokosta, Leko Qiro Çipi, Leko Pilo Leku, Llambo Pilo Leku, Mako Aleks Maku, Noto Koço Duka, Petro Mihal Zografi, Zoto Gole Qirjazi, Mihal Gole Qirjazi.

Trualli ku lindi...

Panajot Pilo Leku u lind në Qestorat të Lunxhërisë, më 12 korrik 1924, në një familje të njohur atdhetare. Babai i tij, Pilo kishte qenë për mjaft kohë pjesëtar i çetave patriotike të zonës dhe kishte luftuar për liri dhe pavarësi. Me ndjenjën e atdhetarisë u formua dhe u edukua edhe Panajoti që në rininë e hershme të tij, duke dëgjuar histori për bëmat e luftëtarëve, si dhe heroizmin e mësuesit të Rilindjes Koto Hoxhi.

Panajoti, pasi mbaroi shkollën fillore të fshatit, u përgatit për të marrë rrugën e kurbetit. Kurbeti në atë kohë ishte në modë, burrat e fshatit Qestorat dhe të krahinës së Lunxhërisë, e kishin pranuar në heshtje një ndërmarrje të tillë. Në kurbet nga kjo familje kishin shkuar gjyshi, babai, si dhe vëllezërit e tij. E ëma, Gatho e përcolli Panajotin, djalin e katërt të saj për në kurbet. Ajo mbeti e vetme në shtëpi, duke ruajtur zakonet e traditat e familjes dhe të vendit. Në kurbet Panajoti kreu shkollën e mesme, por dhe punoi në punë provizore, e nga më të ndryshmet për të siguruar bukën e gojës dhe shkollën...

Kthehet në atdhe dhe bashkohet me lëvizjen

Në vitin 1941 kthehet në Atdhe dhe nëpërmjet të njohurve punësohet në qytetin e Durrësit. Këtu aktivizohet në rrethet antifashiste të këtij qyteti, duke marrë pjesë në demonstrata, në shpërndarje traktesh, në aksione të njësitit gueril dhe veprimtari të ndryshme kundër fashizmit. U aktivizua shumë me Rininë Komuniste. Kishte rënë në sy të spiunëve të fashizmit dhe nuk mund të qëndronte më në qytet dhe të zhvillonte veprimtari. Kështu, në fillim të vitit 1943 kthehet në Lunxhëri. Panajoti aty u mësonte të rinjve të Qesaratit tek lokali i shkollës së fshatit këngë partizane. E tillë ishte kënga: O e mërkurë njëzetë e nëntë./ Muaji i marsit në mbarim,/ Lufta filloi, o që me natë,/ Hidheshin trimat,/ Përpara me guxim... Vargjet e këngës i kushtoheshin njëres prej betejave të shumta të luftës partizane të Qarkut të Gjirokastrës.

Fillimisht Panajoti del partizan në çetën partizane “Mihal Duri” dhe më pas në batalionin partizan “Misto Mame”, që u formua në Stegopull të Lunxhërisë, më 8 gusht 1943. Me batalionin mori pjesë në shumë luftime, ku u dallua për guxim e trimëri, si në luftimet në Qafë Gjashtë, në Sarandë, në Dhrovjan, në Delvinë, në Cepo, etj.

Panajoti me shumë luftëtarë të njohur të Lunxhërisë u rreshtua në BrVIS, e cila përrurimin e saj e bëri në zjarrin e luftës. Nga data 26 janar 1944, që është dhe dita e formimit të kësaj njësie partizane, forcat gjermane, të ardhura nga dy drejtime: Këlcyrë-Përmet dhe Tri Urat-Përmet, bënë që për 8 ditë të zhvilloheshin luftime të ashpra në Kuqarr, në Varibop, në Kosinë, në Zelush, në Petran, te Guri i Bardhë, në Badilonjë etj., si dhe të dështonte plotësisht operacioni armik në luginën e Përmetit. Gjatë kësaj periudhe brigada bashkërendoi veprimet e saj luftarake edhe me BrVS dhe BrIS, si dhe me batalionet territoriale të zonave, edhe me partizanët e Zonës Parë Operative, me komandat e vendit, me Këshillat Antifashistë Nacionalçlirimtarë të fshatrave. Në luftimet e zhvilluara spikati gjithmonë guximi, trimëria e kuadrove të saj, si komandantët, komisarët, komunistët e partizanët në tërësi.

Lunxhëria, ka qenë e çliruar me periudha gjatë luftës. Më 5 shkurt 1944, dy batalione të BrVIS nga Përmeti dolën, njëri në Sheper të Zagorisë dhe tjetri në Polican të Pogonit. Prej këtej shkuan në fshatrat e Lunxhërisë, dhe i spastruan njërin pas tjetrit nga nazistët dhe nga tradhtarët.

Në Qestorat u zhvillua një përlshje e përgjakshme që shkoi deri në kacafytje trup me trup. Erdhi një çast që s’kishte asnjë vijë të përcaktuar të njërit e të tjetrit kundërshtar, derisa më në fund unaza e armikut u shkatërrua në aq vend sa nevojitej që të rrethuarit të dilnin nga rreziku. Si u krye kjo detyrë, komanda e

Komisar Panajot Leku, përjetë midis nesh



brigadës urdhëroi tërheqjen e të gjitha forcave, që u zhvillua në rregullin më të plotë. Ndërkohë kishin dështuar edhe orvatjet e armikut për të kapur grykën e Selckës e për të krahëmarrë forcat e brigadës që luftonin në Qestorat. “Armiku, - raportonte shtabi i BrVIS, - i tronditur nga grushtet e rënda që hëngri, as që tentoi të përparonte më. Grumbulloi të vrarët e të plagosurit dhe u tërhoq për në Gjirokastrë. Kishin rënë në përlshje të përgjakshme me armikun disa luftëtarë, ndërmjet të cilëve Sadik Buzoja, komandant batalioni, Halil Ymeri, Sejdi Minga, komandant e zëvendëskomandant kompanie. Të plagosur ishin 13 partizanë. Në Lunxhërinë e çliruar, ashtu si në Zagori, Pogon e Përmet u rivendos menjëherë pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë. Nga ky luftim Panajoti doli me besimin se lufta partizane do t’i çonte drejt lirisë.

Në detyrën e përgjegjësit të rinisë dhe komisar

Me krijimin e BrVIII, u emërua përgjegjës rinie dhe, pak më pas, komisar kompanie. Komisar partizan 20 vjeçar, një djalë i gjatë, i pashëm, gazmor, i dashur dhe shumë i respektuar. Fillimisht, BrVIII e nisi operacionin kundër armikut në mbrojtje të delegatëve dhe mjediseve ku po përgatitej Kongresi Historik i Përmetit, duke zënë pozicionet luftimi nga Ura e Dragodit, Rëzë, Lunxheri, Gryka e Çajupit, Gryka e Salckës, Pogon, Dhembel, Nemeçkë e deri në fshatrat e Përmetit si Çaçovë, etj. Operacioni i Qershorit 1944 ishte prova më e vështirë, por edhe kalitja vendimtare për partizanët e brigadës. Prej datës 17-26 qershor 1944, për afro dhjetë ditë u zhvilluan luftime të ashpra në Lunxhëri, Çajup, Pogon e Zagori.

Në gusht të vitit 1944, Panajoti zgjidhet delegat i BrVIII në Kongresin e BRASH-it, që u mbajt në Helmës. Zëri i delegatëve të zgjedhur nga partizanët më të mirë, të dalluar në luftën kundër pushtuesve, në takimet dhe bisedat e zjarrta që bëheshin gjatë ditëve të zhvillimit të Kongresit, dëgjohej me vëmendje të veçantë. Me diskutimet e tyre, dhanë një kontribut të vyer për përcaktimin e detyrave imediate që i dilnin Rinisë Antifashiste Shqiptare, për edukimin e saj dhe për çlirimin e rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta. Për 10 ditë rresht Kongresi i BRASH-it diskutoi dhe analizoi punën që ishte bërë për bashkimin e Rinisë Antifashiste Shqiptare dhe sukseset e arritura prej saj në luftën kundër okupatorit nazifashist, si dhe u përcaktuan detyra të rëndësishme për një pjesëmarrje më të madhe të rinisë në repartet partizane dhe për aktivizimin e mëtejshëm në Luftën Nacionalçlirimtare.

Panajoti gjatë operacionit të dimrit pati kaluar një pleurit, të cilin e kaloi duke luftuar, pa u mjekuar. Kjo sëmundje iu rishfaq gjatë punimeve të Kongresit, por ai e përballoi me moshën e re. Në bllokun e shënimeve, që ruhet në arkivin e shtetit, shikojmë sa me vëmendje e ka ndjekur Kongresin, duke marrë pjesë dhe në diskutime, në emër të rinisë së brigadës që përfaqëonte.

Në gusht 1944 brigada me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm mori pjesë në luftimet për çlirimin e Konispolit. Brigada ka luftuar për çlirimin e qyteteve të Gjirokastrës, Beratit, Lushnjës dhe Tiranës, si dhe jashtë kufijve administrativë shqiptarë, duke dhënë një kontribut të madh dhe në çlirimin e viseve kosovare.

Komisari u plagos në çlirimin e Tiranës

Fitorja e 29 Nëntorit 1944, që shënoi çlirimin e plotë të Shqipërisë, ishte dhe fitore e madhe e Rinisë Antifashiste Shqiptare që përbënte 70 për qind të efektivit të forcave partizane dhe që i dha atdheut me qindra dëshmorë në të gjitha krahinat e vendit.

Në luftën për çlirimin e Tiranës luftoi heroikisht dhe u plagos rëndë komisar Panajot Leku nga Qestorati. Çlirimi i Tiranës e zuri në spital. Krahas plagës, komisarit iu riaktivizua dhe pleuritit. Pas një mjekimi relativisht të gjatë, me ato mundësi që ishin atëherë, u përmirësua. Me fillimin e vitit 1945 u emërua në komandën e qarkut të Gjirokastrës dhe mori gradën ushtarake “Toger”. Por, pa kaluar shumë kohë, sëmundja e nënshtroi plotësisht. E rishtruan në spitalin ushtarak në Tiranë, pa asnjë shpresë. Panajoti doli nga spitali i Tiranës, por ishte i dërmuar përfundimisht nga sëmundja, me dëshirën e tij, i shtrirë në krevat, pasi nuk mund të ngrihej në këmbë, shkoi në vendlindjen e tij, në Qestorat, ku mbylli sytë, më 24 korrik 1946. Panajoti vdiq nga plagët e luftës.

Në varrimin e tij morën pjesë gati të gjitha fshatrat e Lunxhërisë, Komanda e Qarkut Gjirokastrë, pushteti vendor. Ceremonia mortore u krye sipas protokollit ushtarak, me të gjitha procedurat e dëshmorit të LANÇ-it.

Më pas Panajot Leku u konsiderua dëshmor i luftës, por familjes së tij, nuk iu dha asnjë dëshmi apo dokument që të vërtetonte një gjë të tillë. Në vite është shkruar për të si partizan dhe dëshmor, por akt ligjor për Panajotin që vdiq nga plagët e luftës, nuk pati kurrë. Në historikun e batalionit partizan “Misto Mame”, figuron dëshmor, por në realitet, nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë qenien dëshmor të këtij komisar që luftoi dhe u plagos për lirinë.

4 shkurti në historinë e përbotshme, ishte simbol terrori dhe masakre, por dhe simbol i një lufte të shenjtë që rritej dhe nuk shuhej. 4 shkurti nxori në shesh para popullit figurat e vërteta të çakejve të reaksionit, zbuloi gjurmët e tyre me gjak e tradhti, lidhjet e tyre me okupatorin gjerman dhe rolin e tyre si xhelatë e tradhtarë të popullit. 4 shkurti qe prelud i çlirimit të Tiranës. Si sot 80 vjet më parë, nën drejtimin e pushtuesve nazistë gjermanë, forcat e xhandarmërisë dhe policisë sekrete të qeverisë kuislinge të Rexhep Mitrovicës, të regjimentit mercenar “Kosovar” dhe ballisto-zogistëve kryen mbi popullin e Tiranës, krimin më të madh dhe më çnjerëzor që njih historia e LANÇ-it, ku me egërsi çnjerëzore në natën e 4 shkurtit rrëmbyen nga gjiri i familjeve mbi 500 të rinj patriotë, ku nga këta, 84 shqiptarë u pushkatuan në rrugët e sheshet e Tiranës. Atë natë, Tirana u la me gjakun e bijve të saj të pavdekshëm, që ne sot i përkujtojmë me dhimbje dhe respekt të lartë.

Nga dokumentet arkivale, nga kujtimet e shumë veteranëve që përjetuan këto ngjarje, nga tregimet e disa pjesëtarëve të familjeve të kësaj masakre si dhe nga deponimet e bëra nga disa ish-kryepreq të lagjeve të Tiranës që u morën me forcë në bastisjen e shumë familjeve dhe arrestimin e shumë viktimave, rezulton se për këtë masakër çnjerëzore, nazistët-kuislingë-ballistë që më parë kishin hartuar një skenar në një takim që ishte bërë, më 16 janar 1944, në zyrën e ish-kryeministrit të qeverisë kuislinge Rexhep Mitrovicës, ku në të kishin marrë pjesë vetë kryeministri Xhaferr Deva, ish-ministër i Brendshëm, Hysni Derna komandant i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, Kadri Cakrani komandant i forcave të Ballit Kombëtar, Qazim Mulleti ish-prefekt i Tiranës dhe një oficer i Gestapos gjermane. Objektivi kryesor që synonte të realizonte në këtë operacion terrorist ishte që t’i jepej një goditje e rëndë asgjësuese organizatës së Partisë Komuniste dhe të Frontit Nacionalçlirimtar të Tiranës. Kjo do të bëhej si kundërpërgjigje që pësuan forcat ushtarake gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre gjatë operacionit që bënë në muajt nëntor 1943 - janar 1944 kundër ushtrisë nacionalçlirimtare. Të arrestoheshin dhe të pushkatoheshin personat që përfshiheshin në listat e hartuara nga policia sekrete, në to figuronin në radhë të parë emrat e drejtuesve të qarkorit të P. K. të Tiranës me në krye Gogo Nushin e komunistë të tjerë aktivistë të rinisë komuniste dhe të Frontit Nacionalçlirimtar, të gruas antifashiste, nacionaliste, patriotë dhe pjesëtarë të njësiteve guerile. Të zbuloheshin dhe të asgjësoheshin të gjitha bazat ilegale të LANÇ-it, ku ishte teknika e Partisë, ku ishin strehuar ilegalë, partizanë të plagosur dhe të sëmurë dhe këta të arrestoheshin, të pushkatoheshin. Të gjithë personat e dyshimtë të arrestoheshin dhe të burgoseshin në burgun e Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë (ish-gjimnazi i Tiranës). Operacioni do të mbahej shumë sekret dhe do të fillonte në orët e pasdites së 3 shkurtit 1944, dhe do të përfundonte në orën 5 të mëngjesit të datës 4 shkurt 1944. Ky operacion do të drejtohej nga Xhaferr Deva dhe Kadri Cakrani. Në këtë operacion terrorist, forcat e Gestapos gjermane nuk do të merrnin pjesë, pasi në një dokument të Komandës së Përgjithshme të Korparmatës së 21-të gjermane, thuhej: “Grupet nacionaliste sot natën do të ndërmarrin një kundër-reaksion. Të gjithë pjesëtarët e trupës gjermane në postat e shërbimit të qëndrojnë jashtë kësaj grindjeje”. Ky ishte një mashtrim, që synonte t’i paraqiste forcat gjermane të ardhur në Shqipëri jo si pushtuese, por si kalimtare, si nevojë e sigurimit të krahëve të forcave gjermane në jug të Ballkanit dhe të sigurimit të rrugëkalimit të këtyre forcave për në veri të Evropës. Por më vonë, në dokumentet gjermane të zbuluara vërtetohet se në krye të drejtimit të këtij aksioni ka qenë oficeri i Gestapos gjermane, Haufmanlangen, përfaqësues personal i Hitlerit në Shqipëri. Nga qeveria demokratike e Shqipërisë, në vitin 1945, i është kërkuar shteteve të mëdha të koalicionit antifashist Angli-SHBA-BRSS, që ky person të gjendej dhe të gjykohej për krime lufte.

Forcat që do të merrnin pjesë në këtë operacion përbëheshin nga xhandarmëria dhe policia sekrete kuislinge, nga forcat e regjimentit mercenar “Kosovar”, që kishin ardhur në Shqipëri për ta shpëtuar atë nga regjimi komunist dhe nga forcat e armatosura të Ballit Kombëtar. Ata vepruan të organizuar në grupe me nga 10-15 veta dhe në drejtime të caktuara. Në krye të tyre ishin agjentët e Gestapos, Qazim Mulleti, Osman Kukaleshi, Xhelal Staravecka, Seit Matja dhe drejtues kryesor të organizatës së Ballit Kombëtar të Tiranës, Halim Begeja, Halil Mëniku, Seit Demneri, Arif Merepeza, Osman Kazazi, Zige Hatipi dhe të tjerë. Sipas skenarit operacioni filloi në orët e pasdites së 3 shkurtit 1944 dhe kjo vërtetohet edhe nga njoftimi i bërë nga ATSH, ku thuhej: “Në orët e para të kësaj dite, disa grupe terroriste kanë tentuar të bëjnë atentat kundër qeverisë, personaliteteve të larta shqiptare, kundër Xhaferr Devës, Kadri Cakranit dhe kanë sulmuar automobilat e tyre me bomba dhe revolver”. Në këto përpjekje u vranë disa atentatorë. Duke marrë shkas nga këto atentate të inskenuara, Xhelal Staravecka dhe Kadri Cakrani, me agjentët e tyre në Tiranën e Re, arrestuan qytetarë të pafajshëm, të cilët ishin duke shkuar nga puna në shtëpitë e tyre dhe i pushkatuan. Këta ishin Todi Shkurti, Vangjel Kapo, Hasan Çeliku dhe Jani Koçi. Ketë krim e justifikuan se gjoja ata paskan vrarë një tregtar, të quajtur Fahri Osmani dhe kishin

80 vjet nga nata e ‘Shën Bartolomeut’ shqiptar



plagosur disa qytetarë të tjerë. Fill pas kësaj ngjarjeje, qindra forca të xhandarmërisë, të policisë dhe të regjimentit mercenar “Kosovar”, të armatosur gjer në dhëmbë, vendosën patrulla nëpër rrugët e Tiranës, dhe nga kjo kohë u vendos ndalim-qarkullimi. Duke filluar nga ora 2:00 e natës dhe deri në mëngjesin e ditës së 4 shkurtit, bastisën qindra shtëpi, u arrestuan mbi 500 qytetarë, prej të cilëve 84 u pushkatuan. Shumica e të pushkatuarve ishin antifashistë, aktivistë të Frontit Nacionalçlirimtar, të rinj komunistë dhe disa ishin punëtorë që dolën të shkonin në punë në mëngjes herët. Nga të pushkatuarit pati dhe me kombësi italiane, si dhe 4 të burgosur malazezë, që me gjakun e tyre lagën sheshet dhe rrugët e Tiranës. Kështu ndodhi nata e Shën Bartolomeut shqiptar, ku Tirana u gjakos por nuk u mposht. Në mëngjesin e 4 shkurtit 1944, kufoma të vrarësh, të mbytura me gjak, ishin kudo nëpër rrugët dhe sheshet e Tiranës, kështu: Para Sahatit dhe Xhamisë ishin 12 punëtorë të pushkatuar, nga këta, 4 ishin



punëtorë italianë. Në fund të Bulevardit, afër maternitetit ishin 4 malazezë të pushkatuar, ish-të burgosur politikë të nxjerrë nga burgu. Në rrugën e Pishës ishin 3 të pushkatuar. Para Xhamisë në rrugën e Kavajës ishin 3 të pushkatuar. Në rrugën e Shën Gjergjit ishin 7 të pushkatuar.

Shumë viktimat të vrarë, u ishin prerë gishtat e duarve dhe u ishin rrëmbyer unazat dhe dhëmbët e florinjë. Kufomat e të pushkatuarve qëndruan deri në orën 10.00, pastaj me makina xhandarmëria i dërgoi ato në morgun e spitalit. Nga dokumentet arkivale rezultoi se nga 84 të pushkatuarit janë identifikuar vetëm 29 viktimat dhe këta ishin Ramiz Treni dhe Sitki Qigo, antifashistë, të dy profesorë në gjimnazin e Tiranës, Xhemal Sojli, Harito Harito dhe dr. Stefan Pano antifashistë dhe aktivistë të Frontit Nacionalçlirimtar, Fadil Rada, vëllezërit Maliq dhe Haki Huta, Sulejman Vrapit, Gjergj Legisi, Islam Alla, Fiqiri Gerblleshi dhe Ali Visha (trupit i të cilëve u gjet në lumin e Tiranës), aktivistë të rinisë komuniste dhe pjesëmarrës

të njësiteve guerile; Vingenca Apoli dhe raxhioner Ravesi të dy antifashistë italianë, Gjergj Marangozi, antifashist malazez, David Kohe, çifut, Mina Thome, nga Vlora, i marrë nga hotel Parku, Vangjel Kapo, Vasil Muzina, Petro Prifti, Sokrat Tako, Mihal Kogo, Dhimitër Torna, Emrullah Korja, Todi Shkurti, Osman Boriqi, Kurt Uka, Lake Kolonja e Hasan Çeliku, punëtor.

Ja ç’ tregon Havaja, nëna e Fadil Radës, për natën e 4 shkurtit 1944: “Isha vetëm në shtëpi me djalin e vogël, Fadilin, se dy djemtë e tjerë, Ademi dhe Isufi, ishin partizanë. Në orën 20-00 të natës, xhelatët e armatosur thyen derën dhe më morën Fadilin. U ngjita pas djalit tim, por katilët më shtynë dhe më shkëputën nga ai. ‘Lidheni qenin!’, bërtisnin Qazim Mulleti dhe Osman Kazazi dhe mua më përplasën në fund të oborrit, ku dëgjova për herë të fundit Zërin e Djalit tim të shtrenjtë duke më thënë: ‘Nënë, shko në shtëpi’, për dy ditë radhazi nëna me bukë në gji, kërkoja nëpër Tiranë, që të gjeja djalin dhe t’i jepja

për të ngrënë, por nuk e gjeta. Ah, unë e zeza! Pas dy ditësh shokët e tij ma sjellin trupin që e kishin gjetur në një gropë jashtë Tiranës, në rrugën e Elbasanit. Por mane zeza nuk e njohu Dilin, se e kishin copëtuar xhelatët. Qava dhe lotët për të s’ mu thanë kurrë”. (Marrë nga gazeta “Bashkimi” e datës 4 shkurt 1945). Kjo mëmë trime tiranase ka qenë e arrestuar nga kuestura në vitin 1943, kur u vra Xhorxhi Martini, të cilin e kishte strehuar të plagosur në shtëpinë e saj. Ndërsa trupat e dy vëllezërve, Maliq dhe Haki Huta, aktivistë të rinisë komuniste dhe të Frontit Nacionalçlirimtar, nuk janë gjetur, edhe sot e kësaj dite nuk dihet ku janë varrosur. Në një bisedë që kam bërë me vëllain e tyre për nënën, Mehmet Shkëmbi, kam mësuar se ai ka qenë së bashku me vëllezërit e tyre në shtëpi natën e 4 shkurtit 1944, kur ata u

arrestuan. Ai tregon: “Ishte ora 3 pas mesnatës, ku mbi dhjetë xhandarë me në krye Osman Kazazin dhe një farë kapter Selimi, goditën portën me qytat e pushkëve dhe me të thirrura kërkonin që ta hapnim derën. Në shtëpi ishin baba, nëna, dy motrat dhe tre vëllezërit. Shtëpia dhe rruga e Kazanëve ishte e rrethuar nga forcat e xhandarmërisë dhe ne nuk kishim mundësi të dilnim nga rrethimi. Në fillim hezitua ta hapnim portën, por pasi dëgjuam edhe zërin e ish-kryeplakut të lagjes, Xhemal Zela, e hapëm. Me një egërsi shtazore ata hynë në shtëpi dhe na arrestuan të tre ne vëllezërve, na lidhën duart dhe i thanë babës se do të na çonin te Xhaferr Deva. Masakrat ndaj këtij populli që luftoi pa u trembur përballë ‘shpurave fashiste’, janë dhe do të mbeten pikë referimi për brezat, të cilët duhet të mësojnë se çdo pëllëmbë toke e atdheut tonë është larë me gjakun e djemve dhe vajzave të cilët nuk kursyen ‘të ritë’ e tyre para dorës vrastare.

Referuar historianit Doc. Kadri DINGU

Karl Gega, gjeniu shqiptar mes shkëlqimit të Moxartit, Frojdit dhe Kafkës

Karl Gega, figurë e shquar shqiptare e teknikës hekurudhore në shek. XIX, ndërtuesi gjenial i hekurudhës së famshme të Semmeringut. Karl Gega lindi në Venedik, më 10 janar 1802 dhe vdiq në Vjenë, më 14 mars 1860, duke vrarë veten nga dëshpërimi. Të parët e Karlit kishin mërguar në Venedik së bashku me shumë bashkatdhetarë të ikur nga Shqipëria Veriore, pas pushtimit osman.

Si individ, Karl Gega u zhvillua para kohe. Mbasi kreu një kolegji për filozofi e matematikë me rezultate të shkëlqyera, në moshën 15-vjeçare u regjistrua në Universitetin e Padovës. Vetëm mbas një viti u diplomua në degën e inxhinierisë. Më 1819, kur sapo kishte mbushur 17 vjeç merr titullin “Doktor në matematikë”.


Iu kushtua ushtrimit praktik të inxhinierisë në shërbim të hekurudhave të Mbretërisë Lombardo-Venete (krahinë e Perandorisë Austriake), duke u marrë edhe me trasimin e rrugëve, kanaleve dhe ndërtimin e godinave të mëdha. Ai punoi në hapjen e rrugës së madhe malore në provincën e Belunos. Gjatë periudhës 1824-1830 në provincën e Trevisos, në një pjesë rruge drejtoi punimet edhe nga ana hidraulike. Nga 1830-1833 ishte inxhinier në Rovigo dhe pastaj deri në vitin 1836, u caktua në departamentin e ujërave, pranë drejtorisë së bujqësisë në Venedik. Në vitin 1840 u gradua dhe u bë zëvendës në Drejtorinë e ndërtimeve për mbarë Tirolin. Aty projektoi rrugën malore që kalon nëpër Val Sugana, pastaj atë që kalon nëpër Oberinnthal, dhe bëri projektin e urës së varur mbi Etsh pranë Mores. Në vitin 1848, si inspektor i Drejtorisë së Përgjithshme të Ndërtimeve, drejton ndërtimin e hekurudhave të Jugut deri në Laihah. Në këtë kohë bëri një udhëtim të gjatë studimi në Gjermani, Belgjikë, Francë e Angli dhe, me t’u kthyer, hyri përsëri në shërbimin e hekurudhave shtetërore dhe u mor me trasimin e linjës hekurudhore të Semmeringut, tunel i gjatë 1430 metra, në atë kohë diskutohej lidhur me mundësinë e trasimit të një hekurudhe me kaderencë të thjeshtë. Kësaj zgjidhjeje ai iu kushtua mbas një udhëtimi të ri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Angli. Më 1849 u bë drejtor i Seksionit të Ndërtimit të Hekurudhave dhe më 1850 drejtor i drejtorisë së përgjithshme për ndërtimin e hekurudhave shtetërore në Vjenë.

Zgjidhja e problemit të hekurudhës së Semmeringut nga Karl Gega u kundërshtua nga shumë specialistë, mbasi asokohe diskutohej shumë rreth vështirësive që lokomotiva të ngjitej në atë lartësi me kaderencë të thjeshtë, por eksperiencia provoi se ishte një gjë e mundshme, siç e kishte parashikuar ai, që lokomotiva me tren të përshkonte një pjerrësi 25% dhe rreze 180 metra. Enkas për hekurudhën malore të Semmeringut u shpall një konkurs midis konstruktorëve të lokomotivave për të ndërtuar një lokomotivë më të fuqishme, sepse zgjidhja e problemit kushtëzohej edhe prej forcës tërheqëse të lokomotivës. Në vitin 1860 përfundoi kjo linjë që është shembulli i parë i hekurudhave malore.

Gjatë linjës së kësaj hekurudhe u ndërtuan 16 ujësjellës, me gjatësi të përgjithshme prej 1502 metra dhe 15 tunele, me gjatësi të përgjithshme prej 4520 metra. Përveç këtyre u ndërtuan disa qindra ura të vogla dhe një mori muresh mbrojtëse për sigurimin e trenave nga shembjet e dheut. Për të gjitha këto u hodhën në erë 1 500 000 m3 shkëmbinj, u zhvendosën 3 500 000 m3 dhe, u stivuan 65 000 000 tulla dhe u ngritën 80 000 blloqe guri. Asokohe, për shpimin e formacioneve shkëmbore, s’kishte mjete të tjera veç turjelave me dorë. Edhe në ndërtimin e ujësjellësve dilnin shumë vështirësi, meqë në atë kohë nuk njiheshin vinçat e mëdhenj; ndërtimi i atyre shtyllave madhështore që arrinin deri 45 metra lartësi dhe një gjerësi deri 20 metra, bëhej nëpërmjet skelave të luhatshme. Por vështirësitë e shumta i nxori sidomos shpimi i tunelit kryesor, që është si të thuash pika kulmore e kësaj hekurudhe malore, tuneli i Semmeringut, në lartësi 818 metra mbi nivelin e detit. Ky tunel, për arsye të gjatësisë së tij, nuk u shpua vetëm horizontalisht e nga të dy anët, por edhe vertikalisht në gjashtë vende, për të hapur galeri porsi puse, nga të cilat nxirrej dheu e gurët.

Qasjet për njohjen e Karl Gegës

Mjerisht, të dhënat e jetës dhe të veprimtarisë së Karl Gegës janë mjaft të gjymtuara, aq sa nuk e kënaqin kureshtjen e ligjshme për ta njohur tërësisht. Vitet e fundit të Karl Gegës



KARL GEGA U ZHVILLUA PARA KOHE. MBASI KREU NJË KOLEGJ PËR FILOZOFI E MATEMATIKË ME REZULTATE TË SHKËLQYERA, NË MOSHËN 15-VJEÇARE U REGJISTRUA NË UNIVERSITETIN E PADOVËS. VETËM MBAS NJË VITI U DIPLOMUA NË DEGËN E INXHINIERISË. MË 1819, KUR SAPO KISHTE MBUSHUR 17 VJEÇ MERR TITULLIN “DOKTOR NË MATEMATIKË”.

qenë të mbushura plot me brenga e hidhërime. Pak kohë përpara se të përfundonte ndërtimin e hekurudhës së Semmeringut, qeveria austriake e dërgoi atë në Sibenburg që të ndërtonte një rrjet hekurudhor të ri. Në të vërtetë, kjo ishte një manovër e bërë me paramendim për ta larguar, pikërisht në një kohë kur po përfundonte

vepra e tij kryesore. Ai u mërzit e u shqetësua shumë për këtë luftë që po i bëhej prapa krahëve. Mjaftonte një lajthitje banale e teknikëve, që dy anët e tunelit të mos takoheshin në pikën e dëshiruar, por t’i shmangeshin njëra-tjetrës, në drejtime të kundërta. Gjithçka mund të ndodhte në mungesë të tij. Ndodhej në Vjenë kur dikush i tha se

dy anët e kundërta të tunelit të Semmeringut paskëshin devijuar gjatë shpimit pa u takuar. Ky lajm e tronditi tej mase Karl Gegën. Me dështimin e kësaj vepre, në të cilën ai kishte derdhur të gjithë përvojën e njohuritë, sikur po i gremisej sedra dhe krenaria e tij. Ndoshta vdekja iu duk më e lehtë se sa poshtërimi, përqeshja dhe përbuzja e kundërshtarëve, prandaj përfundoi në vetëvrasje, në një banesë të Vjenës, në rrugën “Kulla e kuqe”, nr.6.

Lavdia pas vdekjes e mjeshtrit

Ndërkohë tuneli i Semmeringut kishte përfunduar me sukses, por Karl Gega nuk arriti të gëzonte përrurimin e veprës së tij madhore.

Karl Gega u vendos në panteonin e njerëzve të mëdhenj. Shtatë vjet më vonë, d.m.th. në 1867, eshtrat e tij u vendosën përfundimisht në një varr përmendore. Edhe në stacionin e Semmeringut, pas dy vjetësh, iu ngrit një përmendore në kujtim të këtij nismëtari të hekurudhave malore. Vite më vonë u emetuan pulla poste dhe kartëmonedha me fytyrën e Karl Gegës. Ndërkohë filluan shtrembërime tendencioze lidhur me kombësinë, gjoja italiane apo gjermane të këtij personaliteti. Por në vetë qarqet e kulturës austriake nuk munguan autorë objektivë, që e kanë vënë në dukje origjinën e tij shqiptare, siç është p.sh. rasti i Friedrich Uallisch i cili thotë: “Karl Gega, ndërtuesi gjenial i hekurudhës së Semmeringut, ka qenë me prejardhje shqiptare, siç dëshmon vetë mbiemri i tij ‘Gega’, që do thotë nga Shqipëria Veriore”.

Karl Gega ka lënë shkrime për teknikën hekurudhore si “Pamje e përgjithshme e përparimeve në hekurudha,1840-1850” (botim 3, Vjenë 1853), “Mbi ndërtimin e urave në Amerikën Veriore dhe kalkulimi i aftësive bartëse të urave Houe” (botin 2, ebd 1855). Gjithashtu ai shpiku një zhalon të përmirësuar si edhe një oktante me nonius për trasimin e kurbave. I tij është koncepti i gjatësisë virtuale të një hekurudhe.

Faktimi i origjinës së Karl Gegës

Gjatë një simpoziumi, zhvilluar në Vjenë më 2005, u argumentua gjeneza e Gegëve mbi bazën e dokumenteve origjinale të gjetura në bibliotekën e Muzeut “Correr” të Venecias, të pabotuara më parë, hartuar në vitin 1835 nga Giovanni Battista Ghega, prift në Kishën e San-Markos dhe kushëri i parë (djalë i xhaxhait) i Karl Gegës. Katragjyshërit e Karl Gegës dhe Giovanni Battista Ghega ishin vendosur në Perast, pranë Kotorrit, në Mal të Zi, pasi u larguan nga Shqipëria, e cila ra plotësisht nën sundimin turk me rënien edhe të Shkodrës më 1479. Prej më shumë se tre shekujsh, ata kishin shërbyer si oficerë marine dhe zyrtarë të lartë të Republikës së Venedikut.

Në këtë simpozium iu dha fund edhe hipotezës mbi vetëvrasjen e Karl Gegës. Mbi bazën e dokumenteve origjinale të gjetura në arkivin e Shtetit të Austrisë dhe Muzeut Teknik të Vjenës, dëshmoi lindjen e Karl Gegës, më 10 janar 1802, (dhe jo më 13 qershor 1802), si dhe provoi se Karl Gega ka vdekur më 14 mars 1860, në Lugeck në Vjenë (hipoteza e vetëvrasjes hidhet plotësisht poshtë) dhe se ceremonia fetare është zhvilluar ne Katedralen kryesore të Vjenës, Shën-Stefan, kurse trupi është varrosur në varrezat e Vahringer-it në Vjenë.

Më 1887, kur këto varreza u shpërngulën, sarkofagu me eshtrat e Gegës u vendos në panteonin e njerëzve më të shquar të Austrisë, pranë Mozartit, Beethovenit, Shubertit, Shtrausit, Brahmsit dhe Alois Negrellit (projektuesit të kanalit të Suezit).

Gega dhe sfidat e tij inxhinierike

Në vitin 1836 Banka “Rotschild” merr me koncesion nga Perandoria Austro-Hungareze, ndërtimin e Kaiser Ferdinand Nordbahn, një hekurudhë që duhet të lidhte Vjenën me Triesten, në drejtim të Karpateve me Galicinë.

Gega merr si detyrë të parë një udhëtim përmes Evropës për të hetuar dhe për të parë problemet e hekurudhave, shikon ato franceze, belge, gjermane dhe arrin deri në Angli, ku takon Stivensonin që furnizon hekurudhat perandorake me lokomotiva. Stivenson kishte parë ndërkohë Amerikën në fillim të viteve ‘30 dhe në kthim kishte publikuar një vëllim, ndoshta ndër të parat me të dhëna nga hekurudhat amerikane në të cilin ilustronte zhvillimet në ndërtimin e urave, hekurudhave dhe porteve.

Me t’u kthyer në Vjenë, Gega u emërua kryeinxhinier i hekurudhës që përmendëm më lart. Një detyrë tepër e rëndësishme e marrë edhe pas mbështetjes së këshilltarit të oborrit Ermenegildo Francesconi, me origjinë nga Veneto.

Loti i parë Vjenë-Bernë, u realizua në 1837, por ishte segmenti i radhës që do të vinte në provë Karl Gegën. Në një kohë rekord për epokën, rreth një vit u përfunduan rreth 150 km hekurudhë, duke realizuar volumet masive, vendosur binarët, dhe duke hapur rreth 600 metra rrugë anësore. Gega direkt dhe në mënyrë indirekte ndoqi

momentet e projekteimeve të Brunelit në ndërtimin e hekurudhave dhe të anijeve dhe u interesua për makineritë me avull, perceptoi dhe kishte intuitën që disa nga këto shpikje të reja mund të përdoren edhe në ndërtimet e hekurudhave dhe sidomos të urave me harqe.

Në Amerikën e Veriut Gega dhe Lohr udhëtuan shumë, studiuan vijat hekurudhore, vagonët, urat dhe në mënyrë të veçantë ato të inxhinierit Squire Uhipple, i cili ishte i pari që projektoi ura me strukturë harkore.

Uhipple ishte marrë më realizimin e hekurudhës Baltimorë-Ohajo, ku urat ishin ndërtuar me sistemin Houe, në të cilin Gega ishte një admirues. Me t’u kthyer në Vjenë, Gega e përmbledh eksperiencën e tij amerikane në dy libra në të cilat njërin kushtuar urave hekurudhore. Në këtë kohë filloi ndërtimi i segmentit nga Vjena në drejtim të jugut qe përfundon nën drejtimin e Gegës dhe Lohr në tetor 1884.

Katër vite më pas përfundoi segmenti Celje-Laibach, por ai ishte edhe viti i revolucionit. Gega mori detyrën për të realizuar veprën e tij më të rëndësishme, hekurudhën e Semeringut, që prej të gjithëve quhej e pamundur për t’u realizuar. Semering ishte një terren i vështirë, megjithëse jo shumë i lartë (rreth 1000 metra) i rrethuar nga male dhe lugina që arriheshin me shumë vështirësi, ai



përfaqësonte kufirin në mes të Austrisë së ulët dhe Stirias dhe ishte një vend antik tranziti drejt Vjenës që vinte nga Adriatiku.

Ky terren ishte zgjedhur sepse dukej më i sigurti për të arritur Adriatikun në krahasim me të tjerët, shumë afër më Hungarinë dhe Slloveninë të konsideruara si territoret më të paqarta të perandorisë.

Një ushtri punëtorësh, rreth 20 mijë persona, me familjet e tyre, filluan të punonin në një perimetër prej rreth 40 kilometrash në fund të vitit 1848, rreth 1 mijë nga ato nuk u kthyen nga ky kantier, duke humbur jetën në aksidente apo sëmundje të ndryshme.

Gega u mbyll në një lokal fshati dhe e transformoi në shtabin e tij të përgjithshëm, ishte i mbështetur nga Lohr që merrej me ndërtimin e ndërtesave dhe anekseve të tjera të hekurudhës dhe kishte rreth 50 inxhinierë dhe arkitektë në drejtimin e punimeve të ndarë në lote.

Ekoja e këtij revolucioni u ndje edhe në mes luginave të egra të Semeringut, ku ishin luftëra të brendshme, sabotime e sulme, por në pranverën e 1849 punimet rifilluan pa ndërprerje, duke mbetur i paqartë akoma ndërtimi i një lokomotive që do të mund të ngjitej në ato shkrepa. Vija e parazgjedhur, e gjatë dhe torturuese

ishte përfunduar në vija të përgjithshme dhe ishte modifikuar në përputhje me punimet që kryheshin.

U realizuan galeri të panumërta me gjerësi të tillë që të mund të përballonin dy trase, më e gjata e të cilave është ajo e Semeringut, në një lartësi prej rreth 900 metrash mbi nivelin e detit dhe gjatësi gati 1.5 km. Madhështor është kalimi Kalte-Rinne, përfunduar në tetor të 1853, një lloj ure gjigante e tipit roman, realizuar me harqe me një fuqi të tillë ndërtuese që megjithëse pësoi ndërhyrje për të vënë në punë trenat elektrikë dhe i përballoi me sukses. Por në vitin 1851 mungonte akoma lokomotiva që të mund të bënte të mundur kalimin e vagonëve në pjerrësinë e Semeringut.

U organizua një konkurs për të realizuar një lokomotivë e aftë të tërhiqte të paktën 125 tonelata dhe me një shpejtësi prej rreth 11 km/h në një pendencë 25 për mijë.

Mbi të gjitha lokomotiva duhej të ishte në gjendje të ndalonte në distanca të shkurtra dhe në atë kohë nuk ekzistonin frenat e tipit “Uestinghouse”, të cilat do projektoheshin pas rreth 20 vitesh. Në konkursin për ndërtimin e lokomotivës pas shumë provash fitoi “Bavaria” e shoqërisë “Maffei” e Monakos së Bavarisë, lokomotivë që ishte në gjendje të tërhiqte 150 tonelata me 16 km/h.

Hapi i mëtejshëm ishin linjat hekurudhore drejt Bavarisë, pra

Ti ke forcën që nderon kombin!



QPR